



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:279869

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05801658

2023:163361

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Ismail Kuçi, në lëndën penale ndaj të pandehurit M.K nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.321/23 të dt.10 Korrik 2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 05 Qershor 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Gazmend Salihu, dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij me autorizim, av. I. Q, me dt.10 Qershor 2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.K nga fshati ..., Komuna Kaçanik , rr.”...” pa. i lindur më dt..., nga i ati J...dhe e ëma A..e gjinisë K., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në kompaninë ndërtimore “...”, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:....-

ËSHTË FAJTOR

I. Sepse me dt. 15 maj 2021, rreth orës 15:45, në fsh. ...- Kaçanik, i pandehuri nga automjeti në lëvizje, “..”, ngjyrë e verdhë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, në shenjë gëzimi, ka shtënë dy herë në ajër me armë “...” P.A.K, për shkak se merr vizë pune për në Zvicër.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. Sepse nga koha e pacaktuar deri më datë 15 maj 2021, në fsh. ...- Kaçanik, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në posedim pa leje dhe pa autorizim përkatës armën e tipit “....” cal 9mm, me nr. serik ..., ku pas një kontrolli të kryer nga ana e policisë, arma në fjalë është konfiskuar.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3 dhe nenit 72 par1 nënpar.1.5 , të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim konfor neni 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 800.00 € (tetëqind euro).

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit, me dënim me gjobë në shumë prej 600.00 € (gjashtëqind euro).

Konfor neni 76 par.1 dhe 2 nënpar. 2.4 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 1400.00 (njëmijë e katërqind euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’a paguaje brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në 4 këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendesojë dënimin me gjobë, me dënim me burgim, duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimin në shumë prej 20.00€, të gjitha këto paguhen pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konfor nenit 366 par.3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet arma e tipi pistoletë "...”cal.9mm, me nr. serik: ... , një karikator i zbarzët dhe dy gëzhoja të cal. 9mm P.A.K.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.321/23 të dt.10 Korrik 2023, të pandehurin M.K nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Përdorimi i armës apo mjeteve të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 05 Qershor 2024.

Prokurori I shtetit Gazmend Salihu në fjalën e tij, me rastin e prezentimit të aktakuzës , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shprehur pendesë për veprimin e tij dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe I kërkon gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së,

andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi I fajësisë për të pandehurin dhe t'I shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke e patur parasysh si rrethanë rënduese, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi I fajësisë dhe keqardhja e shprehur nga I pandehuri për veprën penale.

Mbrojtësi I të pandehurit, av. I. Q. në fjalën e tij, në senacën e shqyrtimit fillestar, deklaroi se I mbrojturi I tij, e ka pranuar fajësinë që nga faza e hetimeve ashtu edhe sot para gjykatës, dhe meqë nuk është përsëritës I veprave penale, njëherit kërkon nga Gjykata që me rastin e marrjes së vendimit , këto të merren parasysh si rrethana lehtësuese, dhe të pandehurit t'I shqiptohet një denim sa më i butë, meqë I njejtë është I gjendjes së dobët ekonomike, dhe se I njejtë është betuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale. Fjalën e mbrojtësit e ka mbështetur në tërësi edhe I pandehuri.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këto gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform neni 70 të KPRK-së, kështu që si rrethana lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur pendesë dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale dhe faktin se, bazuar në evidencën penale, i njëjtë ka patur edhe një rast tjetër penal, edhe pse jo për veprë penale të kësaj natyre, për të cilën është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.K, i akuzuar për veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja, në

pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e armës të përshkruar si në dispozitiv, u mor në bazë të nenit 366 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 dhe 2 nënpar. 2.1 të KPPK-së

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
2023:163361 datë 10.06.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.